



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2022:144881

Datë: 24.02.2025

Numri i dokumentit: 06893913

**C.nr.2344/2022**

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil,** gjyqtari Taulant Rexhëbeqaj, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Y.K. në çështjen juridike kontestimore të paditëses M.B. me numër personal .... nga Prizreni, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson avokatura Klinaku .... me seli në Prishtinë, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit – Drejtoria Komunale e Arsimit, pagesa mbi bazën e përqindjes së inflacionit, vlera e kontestit 798.61 euro, jashtë shqyrtimit kryesor, më datë 14.02.2025, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I. APROVOHET** pjesërisht e bazuar kërkesëpadia e paditëses M.B. me të cilën ka kërkuar kompensimin e inflacionit përkitazi me pagën bazë, ashtu që, **DETYROHET** e paditura Komuna e Prizrenit – Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësja të kompensohet në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit dhe atë:

- Për periudhën kohore 01.07.2019 – 21.11.2022, shumën prej **772.60 euro**, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë (18.07.2022), e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit.

**II. REFUZHET** pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditëses M.B. përtej shumës së gjykuar sikur në pikën I. të këtij dispozitivi në emër të pagesës mbi bazën e përqindjes së inflacionit dhe atë në shumën prej **26.01 euro, si e pabazuar.**

**III. DETYROHET** e paditura, që në emër të shpenzimeve të procedurës, paditësve t'ua paguaj shumën prej 124.00 euro, në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

**Arsyetim**

Paditësja, përmes të autorizuarit të saj, në këtë gjykatë me datë 18.07.2022, ka ushtruar padi kundër të paditurës Komuna e Prizrenit – Drejtoria Komunale e Arsimit, me të cilën ka kërkuar nga gjykata që ta detyroj të paditurën për pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit, konkretisht për periudhën 18.04.2017, e deri në mbajtjen e seancës përgatitore të paguajë shumën monetare. Ndërsa, përmes parashtresës për precizimin e padisë të datës 26.06.2024, ka

kërkuar ti njihet kjo e drejtë për periudhën kohore 06.07.2019 – 22.11.2022 në lartësi prej 798.61 euro. Shpenzimet gjyqësore i ka kërkuar.

E paditura, në përgjigjen në padi të paraqitur në këtë gjykatë me datë 21.10.2022, e ka kontestuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit si të pa bazuar, duke kërkuar që gjykata të njëjtën ta refuzoj si të pabazuar, duke theksuar se e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë si të pa bazuar. Pretendimet e paditësve se ju takon kompensimi i inflacionit është në kundërshtim me nenin 2 paragrafi 1.1 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, sepse në këtë dispozitë shkruan qartë se përfitues të të gjitha beneficioneve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit janë vetëm anëtarët e Sindikatës së Arsimit-SBASHK-ut. Paditësit ushtrojnë padi në gjykatë për realizimin e të drejtave të tyre pa përfunduar procedura administrative, sepse nuk i ka vazhduar procedurat në Inspektoratin e Punës në Prizren. Padia është në kundërshtim të plotë me nenin 56 të Ligjit të Punës, sepse me këtë dispozitë parashihet decidivisht se çka përfshinë paga shtesë. Andaj çështja e pagës shtesë për shkak të inflacionit siç pretendojnë paditësit nuk lejohet me ligjin e punës, i cili ligj në këtë rast është ligj i veçantë dhe e rregullon çështjen e pagës shtesë dhe rrjedhimisht ligji i veçantë në çdo çështje ka epërsi kundrejt çdo ligji apo akti nënligjor. Pretendimet e paditësve se ju takojnë beneficioni nga Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë, janë në kundërshtim me nenin 90 paragrafët 1.1 dhe 1.2 të Ligjit të Punës të R. Kosovës Nr.03/L-212, sepse sipas këtyre dispozitave marrëveshja kolektive lidhet në mes të organizatës së punëdhënësve dhe organizatës së të punësuarve, ndërsa në këtë rast Komuna e Prizrenit është punëdhënësi dhe nuk mund të obligohet në përmbushjen e kësaj kontrate, pa qenë palë nënshkruese e kësaj kontrate. Tutje ka shtuar se e drejta për kompensim të inflacionit për vitin 2017 dhe deri me datë 23.04.2021, është parashkruar, sipas nenit 353 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve kjo e drejtë është parashkruar. Në fund gjykatës i ka propozuar që padinë dhe kërkesëpadinë e paditësës ta refuzoj në tërësi si të pabazuar. Shpenzimet e procedurës kontestimore nuk i ka kërkuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 398 dhe nenin 399 të LPK, gjeti se kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e themeltë, andaj pa caktuar seancë gjyqësore, vendosi lidhur me kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga parashtrimet e palëve ndërgjyqëse të paraqitura me padi dhe përgjigjes në padi, gjykata ka gjetur se nga kontrata e punës me numër 325/9, e datës 07.09.2020 në versionin e fotokopjuar, shihet se paditësja është e punësuar në SHFMU “Abdyl Frashëri”, në Prizren, si mësimdhënëse. Se e njëjta punon pranë kësaj shkollë si mësimdhënëse vërtetohet edhe nga vërtetimi i lëshuar nga kjo shkollë, me numër 22, të datës 28.01.2025, ku vërtetohet se në shkollë “Hysen Rexhepi” punon nga data 17.09.2018 e deri më sot.

Gjithashtu, në bazë të listës së pagave vërtetohet se e njëjta për punën të cilën e bënë e ka pagën bazë në shumën prej 421.00 euro. Po ashtu gjykata bazuar në Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës ka vërtetuar se shkalla e inflacionit për vitin 2019 ka qenë 2.7%, për vitin 2020 ka qenë 0.2%, për vitin 2021 ka qenë 3.4% dhe për vitin 2022 ka qenë 11.6%. Gjykata provave të lartcekura iu fali besimin e plotë ngase është bërë e besueshme fuqia provuese e tyre, duke u bazuar edhe në nenin 329

par.1 të LPK-së, i cili përcakton se “Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë duhet të zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e cila ka hyrë në fuqi me datë 18.04.2017 dhe asaj të datës 22.01.2021, ku në nenin 35 par.10 parashihet se “Për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja (%) e inflacionit të futet në pagë”, si dhe duke u bazuar edhe në mendimin juridik të gjykatës Supreme të Kosovës nr.214/2023 date 09.10.2023 ku në pikën II parashihet që “Punëtorët në bazë të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 22.01.2021, kanë të drejtë që në pagën e tyre të futet përqindja e inflacionit marrë për bazë shkallën e inflacionit çdo vit, sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës, ashtu siç është përcaktuar me nenin 35, pika 10 të këtyre marrëveshjeve”, ashtu që gjykata erdhi në përfundim se në rastin konkret paditëses i takon e drejta në pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit, si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe atë sipas përlllogaritjes së bërë në këtë mënyrë:

- Për periudhën 01 Korrik 2019 – 31 Dhjetor 2019, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 2.7%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditëses ka qenë 421.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 68.20 euro ( $421.00 \times 2.7\% = 11.36 \times 6 \text{ muaj} = 68.20 \text{ euro}$ ).
- Për periudhën 01 Janar 2020 – 31 Dhjetor 2020, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 0.2%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditëses ka qenë 421.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 10.10 euro ( $421.00 \times 0.2\% = 0.84 \times 12 \text{ muaj} = 10.10 \text{ euro}$ ).
- Për periudhën 01 Janar 2021- 31 Dhjetor 2021, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 3.4%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditëses ka qenë 421.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 171.76 euro ( $421.00 \times 3.4\% = 14.31 \times 12 \text{ muaj} = 171.76 \text{ euro}$ ).
- Për periudhën Janar 2022 - 21 Nëntor 2022, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 11.6%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditësit ka qenë 421.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 488.36 euro ( $421.00 \times 11.6\% = 48.83 \times 10 \text{ muaj} = 488.36$ ), si dhe për 21 ditë të muajit nëntor ( $48.83 \div 30 = 1.62 \times 21 \text{ ditë} = 34.18 \text{ euro}$ ) apo në shumën e përgjithshme prej 522.54 euro.

Ndërsa me paraqitjen e padisë, në gjykatë më datë 18.07.2022 në kuptim të nenit 369 të LMD-së, është ndërprerë parashkrimi për periudhën 01.07.2019 e deri më 21.11.2022, gjykata

konstaton se parashkrimi për kërkesën e paditëses për muajin korrik 2019 ka filluar të rrjedh vetëm pasi që të njëjtit kanë pranuar pagën e muajit korrik 2019, e cila pagë realizohet në fund të muajit rrjedhimisht të njëjtit atëherë janë njoftuar se e paditura nuk ka përmbushur detyrimin për kompensimin e inflacionit për muajin tetor 2019 dhe nga fillimi i muajt vijues saktësisht gusht 2019, të njëjtit kanë mundur të kërkojnë përmbushjen e detyrimit, në bazë të nenit 342 të LMD-së, ku parashihet që *“Parashkrimi fillon të rrjedhë ditën e parë pas ditës kur kreditori të ketë pasur të drejtë të kërkojë përmbushjen e detyrimit, në qoftë se me ligj për raste të veçanta nuk është parashikuar diçka tjetër”* rrjedhimisht këtu paditëses nga fillimi i muajit korrik 2019 ka pasur të drejtë të kërkojë përmbushjen e detyrimit nga këtu e paditura, e që nënkupton se padia e paditëses për periudhën 01.07.2019 e deri më 21.11.2022, nuk është parashkruar pasi që nuk është arritur afati i paraparë me neni 87 të LP-së

Bazuar në të lartcekurat, gjykata duke iu referuar nenit 398 të LPK-së, ku parashihet që: *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”*, ka vendosur si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi. Gjykata ka trajtuar kërkesën e paditësit nga data 01.07.2019 dhe jo siç është specifikuar nga data 06.07.2019 pasi që llogaritja e kërkesës nga paditëses është në tërësi për muajin Korrik 2019 dhe mbi këtë bazë gjykata e ka trajtuar si gabim teknik datën 06.07.2019.

Ndërkaq, gjykata ka vendosur si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke e refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit sa i përket shumës prej 26.01 euro, gjykata refuzoi të pabazuar kërkesën e paditëses sikurse në pikën nën II, sepse në bazë të llogaritjes së gjykatës paditëses për periudhën 01 korrik 2019 – 31 dhjetor 2019 takon shuma 68.20 mbi bazën e përqindjes së inflacionit dhe jo 79.56 ashtu siç është kërkuar ana e paditëses, po ashtu për periudhën janar 2022 - 21 nëntor 2022 në bazë llogaritjes nga ana e gjykatës takon shuma prej 522.54 euro, mbi bazën e përqindjes së inflacionit dhe jo 537.19 ashtu siç është kërkuar ana e paditëses.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore si në dispozitiv, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë në këtë gjykatë (18.07.2022), bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditur është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palëve paditëse.

Sa i përket kundërshtimeve të të paditurës dhënë në përgjigje në padi, gjykata vlerëson se të njëjtat nuk janë të bazuara në dispozita ligjore dhe nuk mbështeten në ndonjë bazë faktike apo juridike. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit meritor.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë konform nenit 449 dhe 453 të LPK-së lidhur me nenin 463 par.1 të LPK-së, duke obliguar të paditurën që në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore, paditëses t’ia paguajë shumën e përgjithshme prej 124.00 euro, sipas Tarifës së Odës së Avokatëve, për përpilimin e padisë shumën prej 104.00 euro dhe për taksë gjyqësore shumën prej 20.00 euro.

Numri i lëndës: 2022:144881

Datë: 24.02.2025

Numri i dokumentit: 06893913

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me dispozitat e nenit 398 dhe nenit 399 të LPK-së.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN**  
**DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL**  
**C.nr.2344/2022, date: 24.02.2025**

**Gjyqtari**

---

**Taulant Rexhëbeqaj**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij Aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit, nëpërmjet të kësaj Gjykate.